



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.22.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VITISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë në konsultim Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit - Erëmira Bytyqi - Pllana, si dhe Anëtarët Hysen Boqolli dhe Mexhit Ferati, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	31
Shtojca III: Letër konfirmimi	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Vitisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Vitisë. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Vitisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Kërkesat e Ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Kërkesat e Ligjit të Buxhetit të vitit 2017;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Vitisë kishte shpenzuar 93% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe. Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt.

Si pasojë e moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet sfiduese, duke rezultuar me mangësi tek menaxhimi i projekteve me bashkëfinancim, lidhja e kontratave përtej mjeteve të planifikuara, marrja e shërbimeve përtej vlefshmërisë së kontratës, etj. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i pagesave, rritja e inkasimit të të hyrave përfshirë menaxhimin e pronave komunale, monitorimi i subvencioneve si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	10,019,298	10,481,182	9,762,874	9,997,117	10,205,713
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,912,603	9,007,603	8,877,644	8,903,175	6,709,184
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	173,431	166,374	141,202	941,113
Të hyrat vetjake ³	1,106,695	1,106,695	688,538	781,569	200,798
Donacionet e brendshme	-	7,776	6,305	4,854	193,460
Donacionet e jashtme	-	185,677	24,013	166,317	2,161,158

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 461,884€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 173,431€, donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë 193,453€ dhe më pas ndarjen e mjeteve nga Qeveria për mallra dhe shërbime në vlerë 95,000€.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 9,762,874€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	10,019,298	10,481,181	9,762,874	9,997,117	10,205,713
Pagat dhe Mëditjet	6,928,119	6,998,291	6,874,613	6,890,048	6,709,184
Mallrat dhe Shërbimet	953,534	1,129,399	941,906	974,180	941,113
Shërbimet komunale	200,862	200,862	200,580	200,287	200,798
Subvencionet dhe Transferet	197,712	340,321	272,706	163,003	193,460
Investimet Kapitale	1,739,071	1,812,308	1,473,069	1,769,599	2,161,158

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale kishte pësuar rritje për 73,237€, si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 186€ dhe donacionit të jashtëm (EU) në vlerë 73,050€, por që pavarësisht kësaj, kjo shumë nuk ishte shpenzuar për shkak të bartjes së donacionit në fund të vitit. Realizimi në këtë kategori ishte 81%. Mos realizimi i pjesës së mbetur ishte për shkak të planifikimit të shpenzimeve nga të hyrat, të cilat komuna nuk kishte arritur t'i inkasoj;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 70,172€ rezulton për shkak të hyrave të bartura në vlerë 55,000€, si dhe donacioneve të jashtme në vlerë 15,172€. Prej tyre, vlera prej 7,622€ nuk ishte shpenzuar për shkak të bartjes së mjeteve në fundvit. Në fund, realizimi kundrejt buxhetit ishte 98%;
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 175,865€. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshinë të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 57,918€, donacionet e jashtme në vlerë 22,947€ si dhe të hyrat nga granti qeveritar në fundvit në vlerë 95,000€. Realizimi në këtë kategori ishte 83%, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur e porealizuar për shkak të planifikimit të shpenzimeve nga të hyrat, të cilat komuna nuk ka arritur t'i inkasoj mjaftueshëm. Ndërkaq, niveli i detyrimeve të papaguara nga kjo kategori ishte 115,764€;
- Buxheti për komunalit nuk kishte pësuar ndryshim, ndërkaq realizimi në këtë kategori ishte 99%; dhe
- Subvencionet dhe transferet në buxhetin final ishin rritur për vlerën 142,609€, si rezultat nga të hyrat e bartura në vlerë 60,326€, donacioneve të brendshme prej 7,775€ dhe atyre të jashtme në vlerë 74,508. Realizimi krahasuar me buxhetin ishte 80%.

Çështja 1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve si rezultat i pagesave direkte nga Thesari

E gjetura Pagesat në vlerë 19,903€ ishin keqklasifikuar si rezultat i ekzekutimit të tyre direkt nga Thesari, bazuar në vendimet e përmbaruesve. Prej tyre, pagesat në vlerë 14,034€ ishin paguar nga komunalit ndërsa ato në vlerë 5,869€ nga investimet kapitale, ndonëse këto shpenzime i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Si rezultat i ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbaruesve, në vlerë 86,813€, komuna kishte paguar shpenzime procedurale në vlerë 9,112€.

Rreziku Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve shpie në paraqitje jo të drejtë të shpenzimit në pasqyra financiare, në këtë rast duke mbivlerësuar shpenzimin e kategorisë së investimeve kapitale dhe komunalive. Në anën tjetër, hyrja në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve, si dhe pranimi i shërbimeve në mungesë të kontratës, ka ndikuar që të ekzekutohen pagesa direkte nga Thesari, duke dëmtuar buxhetin e komunës dhe duke rrezikuar realizimin e projekteve nga kategoritë tjera, nga ku janë marrë mjetet.

Rekomandimi 1 Kryetari të siguroj përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatoreve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që shmangen keqklasifikimet dhe mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.

3.2 Të hyrat

Gjatë vitit 2017, komuna ka inkasuar të hyra në vlerë 707,076€ apo 64% të buxhetit të planifikuar (1,106,695€). Kategoritë nga ku janë realizuar të hyrat janë: tatimi në pronë në vlerë 292,115€, taksa për leje ndërtimi, taksa administrative, si dhe të hyra tjera në vlerë 414,961€. Nga tabela më poshtë shohim se fillimisht ka pasur trend të rënies nga viti paraprak prej 10%. Kjo rënie ishte si rezultat i mungesës së mekanizmave të mjaftueshëm për inkasimin e të hyrave.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,106,695	1,106,695	707,076	786,812	781,607
Totali	1,106,695	1,106,695	707,076	786,812	781,607

Çështja 2 – Dhënia me qira e pronës komunale pa ju nënshtruar procedurave të duhura

E gjetura Sipas Ligjit nr. 04/L-144⁴, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit Komunal (KK), dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, ku pas miratimit nga kuvendi, ky i fundit themelon një komision i cili bën vlerësimin e ofertave, përmes ankandit publik. Ofertat e përzgjedhura, miratohen nga KK dhe dërgohen tek Kryetari për lidhje të kontratës. Komuna nuk kishte vepruar në përputhje me këto kërkesa ligjore gjatë dhënies së pronave komunale në shfrytëzim (me qira), me ç'rast procedurat e ankandit ishin realizuar nga drejtoria e prokurimit, përmes shpalljes publike në KRPP dhe nënshkrimi i kontratave të qirasë ishte bërë nga menaxheri i prokurimit.

Rreziku Mos realizimi i procedurave në përputhje me kërkesat ligjore, rrezikon që dhënia e pronave në shfrytëzim të bëhet në mënyrë të parregullt dhe si rezultat, menaxhimi i pronave të mos bëhet në mënyrën e duhur.

Rekomandimi 2 Kryetari të siguroj se dhënia e pronave komunale në shfrytëzim bëhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe përmes vendimeve nga kuvendi komunal.

⁴ Ligji Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 6,998,291€, ndërsa shpenzimet ishin prej 6,874,613€ apo 98% e buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Auditimi ynë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, vlerësimet vjetore të performancës, pensionimet, pushimet pa pagesë dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtoritë përkatëse, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Çështja 3 – Dobësi në procesin e rekrutimit për personelin arsimor

- E gjetura** Sipas UA nr 17/2009⁵, personelin arsimor në shkollë e përzgjedh Drejtoria Komonale e Arsimit (DKA) në bazë të rekomandimit të komisionit për zgjedhjen e personelit. Në konkursin e shpallur për mësues klasor zëvendësim, komisioni kishte vlerësuar kandidatët me poentim, megjithatë nuk kishte rekomanduar DKA-në për kandidatin e suksesshëm. Si rezultat, DKA kishte nënshkruar kontratën me kandidatin i cili nuk kishte fituar pikët maksimale gjatë procesit të vlerësimit.
- Rreziku** Mos rekomandimi nga komisioni i vlerësimit për kandidatin e suksesshëm, ka ndikuar që të përzgjedhet kandidati jo meritor dhe të ndëshkohet kandidati i cili ishte vlerësuar me më shumë pikë nga komisioni i vlerësimit.
- Rekomandimi 3** Kryetari të siguroj, forcimin e kontroleve gjatë përzgjedhjes së stafit arsimor, me ç'rast komisioni i vlerësimit pas procesit të vlerësimit rekomandon DKA-në për kandidatin e suksesshëm me pikët maksimale në vlerësim dhe kjo e fundit nënshkruan kontratën në bazë të këtij rekomandimi.

⁵ Udhëzimi Administrativ nr.17/2009 për procedurën e përzgjedhjes së personelit arsimor në shkollë

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 1,129,399€. Prej tyre ishin shpenzuar 941,906€ apo 83% e buxhetit final. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me: shpenzime komunale, furnizime për zyre dhe pajisje tjera, derivate dhe lëndë për ngrohje, shërbime kontraktuese, si dhe shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime.

Çështja 4 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit

E gjetura Gjatë vitit 2017, në komunë ishin angazhuar gjithsej 90 punonjës përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Ndonëse sipas ligjit për shërbimin civil, për emërimet të tilla, zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, komuna kishte aplikuar këto procedura vetëm për dy prej të angazhuarve, ndërsa jo edhe për pjesën tjetër. Pozitat për të cilat janë bërë këto marrëveshje, kanë të bëjnë kryesisht me pozita të rregullta dhe jo për ofrimin e shërbimeve të veçanta, siç përcaktohet në marrëveshje.

Rreziku Anashkalimi i procedurave të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, mund të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara. Kjo gjithashtu, nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuar të rekrutimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rast të kërkesave për punë specifike, e jo për pozita të rregullta.

Çështja 5 - Pranimi i shërbimeve pas skadimit të kontratës

E gjetura Kontrata për "Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale" në kohëzgjatje njëvjeçare, kishte skaduar në prill 2017. Përkundër kësaj, komuna kishte pranuar shërbime edhe më tutje përmes një kërkesë të parashtruar nga zyrtari i prokurimit drejtuar ZKA-së, për zgjatje të kontratës deri në nënshkrimin e kontratës tjetër, e aprovuar nga vet zyrtari i prokurimit dhe jo nga ZKA.

Rreziku Pranimi i shërbimeve në mungesë të një kontrate valide, rrezikon pranimin e shërbimeve jo cilësore si dhe realizimin e pagesave të parregullta.

Rekomandimi 5 Kryetari të siguroj fillimin e hershëm të procedurave të prokurimit për kontratat që pritet të skadojnë, duke llogaritur periudhën e ankesave apo pengesave të mundshme, në mënyrë që kontrata të lidhet para skadimit të kontratës aktuale.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 340,321€. Prej tyre, në vitin 2017 ishin shpenzuar 272,706€ apo 80% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndihmë për mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik, aktivitete kulturore dhe sport, si dhe bursa për studentë.

Çështja 6 – Mangësitë në procesin e ndarjes dhe monitorimit të subvencioneve

E gjetura Bazuar në rregulloren komunale për ndarje të subvencioneve, përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna, obligohen që të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ. Poashtu, këtyre subvencioneve duhet t'iu paraprijë një marrëveshje, ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës palë. Në subvencionet e ndara nga komuna, ne kemi hasur në mangësitë, si:

- Komuna kishte ndarë subvencione në vlerë 15,000€ për KF Vllaznia dhe 10,000€ për KF Vitia, por këta të fundit nuk kishin ofruar raportet financiare dhe narrative, për të arsyetuar shpenzimin e mjeteve. Ndërkohë, komuna nuk kishte bërë marrëveshje ku do të përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet mes komunës dhe përfituesit të subvencionit, me ç'rast përfituesit do të kishin përgjegjësi për raportim. Në anën tjetër, drejtoria për kulturë, rini dhe sport ka kërkuar vazhdimisht raportimin e tyre, por përfituesit nuk u janë përgjigjur këtyre thirrjeve; dhe
- Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit mes Komunës dhe UNDP⁶, këto të fundit janë dakorduar të bashkëpunojnë lidhur me implementimin e projektit “Zhvillimi i Integruar Territorial 2”. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi, është nënshkruar një marrëveshje për ndarjen e kostove, ku do të specifikohen shpenzimet që do të përballohen nga secila palë. Megjithatë, në marrëveshjen e arritur, janë specifikuar vetëm kostot e komunës në vlerë 65,000€ dhe jo ato të UNDP. Gjithashtu në transferin e parë nga komuna në vlerë 5,000€, komuna nuk kishte pranuar raport kthyes për këto mjete. Gjatë kohës që ne ishim në teren, me kërkesën e komunës, UNDP ka dërguar një dokument bankar me shumën e pashpenzuar prej 5000€, si pasojë e mos realizimit të aktiviteteve të parapara deri më tani.

Rreziku Mungesa e raporteve për shpenzimin e mjeteve si pasojë e mos përgjegjshmërisë së përfituesve, mund të rezultoj me devijime nga qëllimet e përfitimit të tyre dhe vlerë të ulët për paranë e paguar. Në të njëjtën kohë, mangësitë në aplikimin e marrëveshjeve mes palëve, mund të ndikojnë që palët përfituese të mos jenë të përgjegjshme në realizimin e objektivave dhe raportimin e duhur për mjetet e shpenzuara.

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Rekomandimi 6 Kryetari të siguroj, forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, me ç'rast fillimisht nënshkruhet një marrëveshje ku pala përfituese dakordohet lidhur me detyrimet e saj, e në anën tjetër sigurohen dëshmitë e mjaftueshme për shpenzimin e këtyre mjeteve, në mënyrë që ato të arrijnë qëllimin e synuar.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,812,308€. Prej tyre, në 2017 ishin shpenzuar 1,473,069€, apo 81% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe mirëmbajtjen investive të rrugëve, objekteve arsimore dhe sportive, ndërtimin e parqeve dhe rregullimin e kanalizimeve dhe ujësjellësit.

Çështja 7 – Mangësitë tek projektet me marrëveshje për bashkëfinancim

E gjetura Sipas LPP, në rastet kur një kontratë financohet mbi 50% nga një autoritet kontraktues, ky i fundit është përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit. Në marrëveshjen e komunës për bashkëfinancim me OJQ "Helvetas" për projektin "Ndërtimi i trotuareve, hapësirave të gjelbërta dhe ndriçimit publik në qytetin e Vitisë" në vlerë 142,054€, pjesëmarrja e OJQ-së në financim ishte 49,500€ apo 35% e vlerës së kontratës. Megjithatë, zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe mbikëqyrja kryesore e projektit ishte bërë nga OJQ dhe jo nga komuna, e cila kishte pjesëmarrjen më të madhe në financimin e projektit.

Komuna kishte bërë pagesën në vlerë 10,000€, në llogari të OJQ "Foundation Kosovo-Luxemburg" në kuadër të projektit me bashkëfinancim "Investime të përbashkëta në Komunën e Vitisë", përkatësisht kontratës "Renovimi i kulmit të shkollës fillore 'Kenan Halimi' Skifteraj" në vlerë 33,000€. Këtë pagesë komuna e kishte bërë në formë të paradhënies, në mungesë të një raporti për kryerjen e punëve.

Rreziku Mangësitë e identifikuar në marrëveshjet për bashkëfinancim, sikurse menaxhimi i projekteve nga OJQ-të dhe pagesat në avans në drejtim të tyre, në mungesë të raporteve për kryerje të punëve, rrisin rrezikun që projektet të mos menaxhohen në mënyrën e duhur, objektivat të mos realizohen dhe si pasojë të humbë vlera e parasë së shpenzuar.

Rekomandimi 7 Kryetari, të siguroj se për projektet e bashkëfinancuara më tutje, komuna merr përgjegjësi sipas kërkesave ligjore dhe rol aktiv në zbatimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të këtyre projekteve. Njëkohësisht, të sigurohet se pagesat lidhur me këto marrëveshje, të behën vetëm pas pranimit të raporteve për punë të kryera, bazuar në fatura përkatëse dhe jo në formë të paradhënies.

Çështja 8 - Nënshkrimi i kontratave me vlerë më të lartë se ajo e parashikuar

- E gjetura** Në katër projektet si në vijim, kontratat ishin nënshkruar në vlerë më të lartë se vlera e parashikuar e tyre në Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve dhe në dosjen e tenderit:
- “Ndërtimi i fushave sportive të futbollit dhe volejbollit”, vlera e parashikuar ishte 40,000€, ndërsa kontratat e shpërblyera për dy lote ishin në vlerë 121,175€;
 - “Ndërtimi i stacionit të autobusëve në Viti” vlera e parashikuar ishte 20,000€ ndërsa kontrata në vlerë 39,519€;
 - “Rregullimi i rrugës Dëshmoret e Kombit në Viti”, vlera e parashikuar ishte 123,151€ (bashkëfinancim mes MAPL 100,000€ dhe komuna 23,151€) ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë 152,218 €; si dhe
 - “Asfaltimi i rrugës Germov-Goshicë” vlera e parashikuar e kontratës ishte 150,000€ (financuar nga MI) ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 289,455€.
- Rreziku** Nënshkrimi i kontratave në vlerë më të lartë se ajo e parashikuar, rrezikon mos realizimin e tyre si pasojë e mungesës së mjeteve dhe njëkohësisht mund të rrezikoj realizimin e projekteve tjera për shkak të mundësisë së ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore apo përmbaruesve.
- Rekomandimi 8** Kryetari, të siguroj se fillimisht bëhet një vlerësim i mirëfilltë i planifikimit të buxhetit për projektet e planifikuara dhe nënshkrimi i kontratave nuk i tejkalon fondet e parashikuara për realizimin e tyre.

Çështja 9 - Mungesa e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjes inspektive dhe lejes së përdorimit

- E gjetura** Sipas ligjit të ndërtimit, me rastin e kontratave ndërtimore kërkohet pajisja me dokumentacionin përkatës siç është leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive si dhe leja e përdorimit. Komuna në 12 kontrata⁷, nuk kishte aplikuar lejet ndërtimore dhe mbikëqyrjen inspektive, ndërsa në tri projekte⁸ për të cilat ishte bërë pranimit teknik, nuk ishte lëshuar certifikata/leja e përdorimit. Për më tepër, raporti i pranimit teknik ishte shumë i mangët në informacione, duke mos përmbajtur elementet thelbësore të kontratës.
- Rreziku** Inicimi i projekteve në mungesë të kompletimit të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit për ndërtim, mund të ndikojë në cilësinë dhe ngecjen në realizimin e këtyre projekteve.
- Rekomandimi 9** Kryetari, të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit të ndërtimit, me ç'rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit të sigurohet leja e përdorimit.

Çështja 10 - Mungesa e njoftimeve për tenderët e pasuksesshëm dhe të eliminuar

- E gjetura** Në dosjet e tenderëve “Ndërtimi i stacionit të autobusëve në Viti” në vlerë 39,519€ dhe “Ndërtimi i fushave sportive të futbollit dhe volejbollit” në vlerë 121,175€, mungonin njoftimet për tenderët e suksesshëm, të pasuksesshëm dhe të eliminuar, ndonëse kjo kërkesë është sipas Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).
- Rreziku** Mungesa e njoftimeve për tenderuesit e pasuksesshëm apo të eliminuar, pamundëson të drejtën e tyre ndaj paraqitjes së ankesës në rast të mos pajtimit me vlerësimin e Autoritetit Kontraktues (AK).
- Rekomandimi 10** Kryetari, të siguroj se të gjithë tenderuesit njoftohen me kohë lidhur me rezultatet e procesit të tenderimit, sipas kërkesave të përcaktuara në LPP.

⁷ “Rregullimi i kanalizimeve në komunën e Vitisë” (76,619€), “Renovimi i shkollave në komunën e Vitisë” (79,865€), “Asfaltimi i rrugëve rurale lloti I, II, III” (652,389€), “Ndërtimi i trotuareve” (227,720€), “Ndërtimi i fushave sportive të futbollit dhe volejbollit lot I, II” (121,175€), “Rregullimi i rrugës Dëshmorët e Kombit në Viti”, “Asfaltimi i rrugës Gernove-Goshice” (289,456€), “Asfaltimi i rrugës Devajë - Radivojcë” (139,977€), “Ndërtimi I trotuarit dhe ndriçimi publik në komunën e Vitisë” (142,054€), “Rregullimi i rrugëve më zhavor në komunën e Vitisë” (145,810€), “Ndërtimi i stacionit të autobusëve” (39,519€) dhe “Rivitalizimi i stadiumit të futbollit në Viti dhe Pozharan loti I dhe II” (744,346€).

⁸ “Asfaltimi i rrugës dëshmoret e kombit ne Viti” (152,219€), “Ndërtimi i fushave sportive në hapësirat shkollore” (62,430€) dhe “Asfaltimi i rrugës Devajë - Radivojcë” (139,977€).

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna, regjistrat e pasurive i menaxhonte në mënyrën e duhur, megjithatë çështje të identifikuar në raportet e viteve paraprake ishin përsëritur edhe këtë vit.

Çështja 11 - Mangësitë në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive

E gjetura Përkundër rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake, çështjet e ndërlidhura me pasuritë kanë mbetur sfidë edhe më tutje për komunën:

- Katër shkolla të financuara nga MASHT⁹, të cilat janë në përdorim të Komunës që nga viti 2012, ishin përfshirë në regjistra të pasurisë në mungesë të dokumentacionit mbështetës, por vetëm përmes një e-maili të dërguar nga zyrtarët e MASHT. Përkundër kërkesës nga zyrtari i pasurisë për sigurim të këtij dokumentacioni, MASHT ende nuk iu kishte përgjigjur pozitivisht dhe komuna nuk kishte siguruar dokumentacionin e nevojshëm për bartje të pronësisë; dhe
- Inventari i blerë nga MAPL¹⁰ në vitin 2012, në vlerë 30,000€, nuk ishte përfshirë në regjistra të pasurisë dhe vazhdonte të mbahej i magazinuar në sallën e bibliotekës në Shtëpinë e Kulturës. Kjo pasi pasuria asokohe ishte pranuar nga një komision, ndërsa zyrtari i pranimit nuk kishte qenë i njoftuar për këtë. Që atëherë, ai nuk kishte bërë pranimin e kësaj pasurie dhe regjistrimin e saj në e-pasuri. Kjo nuk kishte ndodhur as pas rekomandimit tonë.

Rreziku Mungesa e dokumentacionit për pasuritë e regjistruara, që janë në shfrytëzim nga komuna, rezulton me paqartësi mbi pronësinë e këtyre pasurive. Ndërsa, mos regjistrimi i pasurive dhe mbajtja e tyre në një sallë, për një kohë të gjatë të pashfrytëzuara, rrezikon dëmtimin apo keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 11 Kryetari të siguroj forcimin e kontroleve në menaxhimin e pasurive, ku në këtë rast, të siguroj se ndërmerren hapa konkret drejt sigurimit të dokumentacionit burimor nga MASHT, si dhe regjistrimit të pasurisë nga MAPL, në regjistrat e pasurive.

⁹ Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji

¹⁰ Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal

Çështja 12 - Inventarizimi i mangët si dhe mos-harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë

- E gjetura** Sipas rregullores financiare 02/2013 për pasuritë jo financiare, komisioni i inventarizimit duhet të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe të hartoj një raport të përgjithshëm mbi gjendjen fizike të pasurive, me gjithë vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara. Komisioni i caktuar për inventarizimin e pasurive nën 1,000€, nuk e kishte kryer në mënyrë të plotë procesin e inventarizimit, pasi nuk kishte krahasuar gjendjen faktike me regjistrat e pasurive dhe as nuk kishte prodhuar një raport përmbledhës me konkluzionet e arritura.
- Rreziku** Mos inventarizimi i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, ku si pasojë e mungesës së informatave të sakta dhe kontrollit jo efektiv, mund të vie deri te keqpërdorimi apo humbja e pasurive.
- Rekomandimi 12** Kryetari të siguroj se procesi i inventarizimit përfshin gjithë pasurinë komunale dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.9 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2017, llogaritë e arkëtueshme (LL/A) ishin 1,921,060€, ku prej tyre pjesëmarrja ishte si në vijim: Tatimi në pronë në vlerë 1,587,903€; Taksa komunale në vlerë 314,157€; si dhe Qiraja në vlerë 19,000€. Vlera totale e LL/A paraqet një vlerë mjaft të lartë marrë parasysh planifikimin e të hyrave për vetëm 1,106,695€ dhe realizimin prej 707,076€.

Çështja 13 – Menaxhimi jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna nuk kishte prezantuar në pasqyrat financiare vjetore, llogaritë e arkëtueshme nga drejtoria për shërbime publike, në vlerë 15,261€. Këto kishin të bënin me shfrytëzimin e hapësirës publike (qiraja). Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos komunikimit të mjaftueshëm për sigurimin e të dhënave mes zyrës së financave dhe drejtorisë për shërbimet publike.

Komuna nuk kishte ndërmarrë masa aktive për inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke bërë që ato të mos shënojnë rënie nga viti i kaluar. Kjo për shkak të mungesës së vendosjes së mekanizmave nga komuna për rritjen e arkëtimit të tyre.

Rreziku Mungesa e informatave të plota rreth llogarive të arkëtueshme, rezulton me menaxhim jo efektiv të tyre dhe pamundëson ndërmarrjen e masave adekuate për inkasimin e tyre. Mungesa e masave konkrete për inkasimin e LL/A, ndikon në mos realizimin e shpenzimeve të planifikuara nga të hyrat. Njëkohësisht, mos prezantimi i saktë i shpalosjeve shpie në një keq pohim të pozitës financiare, ku në të ardhmen mund të ndikojë opinionin e auditimit.

Rekomandimi 13 Kryetari, të siguroj një bashkëpunim më të madh mes drejtorive për të harmonizuar të dhënat lidhur me llogaritë e arkëtueshme, në mënyrë që në të ardhmen ato të prezantohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë në PFV. Po ashtu, kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 231,790€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të komunës së Vitisë ka rezultuar në 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Por, ky plan veprimi nuk ka pasuar më tutje me hapa konkret dhe opsione praktike për adresimin e këtyre rekomandimeve nga personat përgjegjës.

Deri në fund të auditimit tonë, nga 18 rekomandimet e dhëna për vitin 2016, vetëm tri ishin zbatuar; 11 ishin në proces, ndërsa katër nuk ishin zbatuar. Po ashtu, nga viti 2015 nga 13 rekomandime të bartura, një ishte zbatuar gjatë vitit 2017, 10 ishin në proces ndërsa dy nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura

Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ka ndikuar që një numër i vogël i rekomandimeve të janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Moszbatimi i rekomandimeve në vazhdimësi, tregon se kontrollet e menaxhmentit dhe sistemeve tjera financiare nuk kanë funksionuar mjaftueshëm dhe kjo ka rezultuar në:

- Keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mangësi në fushën e prokurimit, si nënshkrimi i kontratave përtej fondeve të parashikuara;
- Dobësi në raportimin e subvencioneve dhe menaxhimin e pasurisë; dhe
- Menaxhim jo i mirë i të arkëtueshmeve dhe dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

Rreziku

Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë, ende mbetin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, vendosja e kontrolleve në fushën e prokurimit, menaxhimi i pagesave dhe marrëveshjeve tek projektet me bashkëfinancim, monitorimi i subvencioneve, menaxhimi i pasurive si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Komuna kishte arritur të përmbushë kërkesën e MF-së për dorëzimin e pyetësorit të vetvlerësimit, si dhe kishte përpiluar listën e rreziqeve, ku ishin identifikuar pika të rëndësishme të rreziqeve me të cilat përballen departamentet përkatëse, duke bërë përshkrimin e masave mbrojtëse ndaj këtyre rreziqeve. Mbetet që më tutje, komuna të bëjë delegimin e këtyre rreziqeve tek individët përkatës apo të caktohet një Komitet për Menaxhimin e Rrezikut, i cili do t'i raportojë Zyrtarit Kryesor Administrativ lidhur me çështjet me rrezik.

Si pjesë të planeve strategjike, komuna posedon Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020, të përbashkët me komunën e Klllokotit, megjithatë ky dokument nuk ka të llogaritur kosto për zbatimin e tij si dhe afate të përcaktuara për arritjen e objektivave.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komiteti i Auditimit (KA) nuk ka qenë mjaft funksional dhe nuk ka arritur të mbajë të paktën minimumin e takimeve të kërkuara gjatë vitit, prandaj nevojitet një punë më cilësore dhe përpjekje

më e lartë e këtij komiteti për të shtyrë menaxhmentin që të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i jashtëm dhe ai i brendshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - drejtori i NjAB dhe një auditor. NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës, ku kishte planifikuar kryerjen e tetë auditimeve. Ne kemi marrë në konsideratë punën e auditorëve të brendshëm, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë në adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimet e KA-së. Ne kemi vlerësuar se NjAB kishte arritur të realizoj deri në një masë planin e saj duke përfunduar shtatë nga tetë auditimet e planifikuara, megjithatë përmirësime të mëtutjeshme nevojiten për një funksionim më efektiv në këtë fushë.

Çështja 15 - Mos zbatueshmëria e rekomandimeve të auditimit të brendshëm

E gjetura Nga gjithsej 25 rekomandime të dhëna, vetëm pesë ishin zbatuar plotësisht, nëntë ishin në proces të zbatimit ndërsa 11 të pazbatuara. Rekomandimet e dhëna kryesisht mbulonin vitin paraprak, e deri në tre-mujorin e dytë të vitit aktual. Këto rezultate tregojnë një mungesë të vullnetit të menaxhmentit për marrjen e përfitimeve nga auditimi i brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Komiteti i auditimit gjatë vitit nuk kishte arritur të jetë mjaft efektiv, duke mbajtur vetëm tri takime, nga minimum katër sa kërkohen sipas statutit të këtij komiteti, si dhe UA 11/2010 mbi funksionimin e KA në sektorin publik. Kjo është pasqyruar edhe tek niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të AB.

Rreziku Mbulueshmëria jo e mjaftueshme e auditimit të vitit aktual dhe aktiviteteve operative në proces ndikon në mosidentifikimin e dobësive aktuale duke rezultuar me joefikasitet në dhënien e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme. Njëherit, moszbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti dhe mos angazhimi i mjaftueshëm i KA në këtë drejtim, redukton efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi 15 Kryetari të siguroj se, fushëveprimi i NjAB-së, të mbulojë sa më shumë periudhën aktuale duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim. Njëkohësisht, të sigurohet një fokus më i lartë i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe një punë më aktive e KA-së drejt përmbushjes së këtij qëllimi.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaft efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 16 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura

Si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve menaxheriale, një vlerë e konsiderueshme e shpenzimeve ishte ekzekutuar përmes vendimeve të përmbauesve dhe atyre gjyqësore, e që i kishte shkaktuar shpenzime shtesë buxhetit të komunës, si dhe kishte rrezikuar realizimin e projekteve tjera të planifikuara, për shkak të tërheqjes së mjeteve direkt nga Thesari nga kategori të ndryshme. Më tutje, mangësitë tek pagesat në avans dhe mbikëqyrja e projekteve me bashkëfinancim, hyrja në obligime kontraktuale përtej mjeteve të planifikuara, pranimi i shërbimeve përtej vlefshmërisë së kontratës, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Kontrollet nuk kishin funksionuar mjaftueshëm as tek ndarja dhe raportimi i subvencioneve, e mangësitë vazhdonin të paraqiteshin edhe tek menaxhimi i pasurisë, sikurse inventarizimi jo i plotë i pasurisë. Poashtu, dhënia e pronave komunale në shfrytëzim nuk ishte menaxhuar si duhet ndërsa vlera e llogarive të arkëtueshme mbetet e lartë, si pasojë e mos vendosjes së mekanizmave adekuat për inkasimin e tyre.

Menaxhmenti nuk posedon raporte të rregullta për aktivitetet operative dhe analiza të hollësishme për ecuritë buxhetore. Komuna ka regjistrit e rreziqeve, megjithatë ende nuk është caktuar pronësia e këtyre rreziqeve dhe mekanizmat e duhur për monitorimin dhe raportimin e tyre tek Zyrtari Kryesor Administrativ.

Rreziku Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë jo të mirë reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, si dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia e rreziqeve të identifikuara tek individët përkatës apo Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut, i cili do t'i raportojë ZKA-së lidhur me çështjet me rrezik, përfshirë rishikime të rregullta (tremujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprimet ashtu siç është planifikuar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmentit i ndërmarrë lidhur me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF.		Ndonëse ka pasur përmirësime gjatë viteve, ende ka mangësi tek shpalosjet e pasqyrave financiare.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj në tërësi Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësisë së lartë, d.m.th. ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i Komunës.		Komuna ka hartuar planin e veprimit, megjithatë nuk janë ndërmarrë masa rigoroze që do të përcaktonin qartë adresimin e rekomandimeve, me ç'rast ka ndikuar që disa nga këto rekomandime të përsëriten.	
Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike gjatë një viti.		Ekzistojnë raportet tremujore, gjashtë mujore dhe vjetore nga drejtoria e financave, megjithatë nuk ka raportime formale nga të gjitha drejtoritë mbi aktivitetet operative në baza të rregullta kohore.	

Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit është funksional dhe kryen detyrat e veta siç kërkohet me ligj. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të monitorimit dhe zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në procesin e raportimit financiar dhe mbikëqyrjen e punës së departamentit të auditimit të brendshëm. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.			Nuk janë marrë masa.
Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit të prokurimit janë zbatuar plotësisht.		Përkundër përmirësimeve, ende ka mangësi në fushën e prokurimit	
Kompenzimet (Pagat dhe Mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.	Po		
Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)	Ne rekomandojmë Kryetarin të ndërmarrë këta hapa: Të ndërmarr hapa për të përmirësuar sistemin e faturimit, të dhe kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrole eficiente dhe efektive në faturim, dhe në të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Të sigurohet që anketimet dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011.		Ende nuk ka një plan real të të hyrave krahas realizimit.	

Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe regjistrimin e saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë.		Regjistrimi i pasurive është bërë saktë dhe në kohë, megjithatë për disa pasuri të regjistruara ende nuk është siguruar dokumentacioni burimor.	
Shpalosja e pasurive jo-kapitale me vlerë nën 1,000 euro	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jo-kapitale dhe të siguroj se pasuritë janë zhvlerësuar në bazë të rregullores në fuqi.		Regjistrimi i pasurive nën 1,000€ është bërë saktë dhe në kohë, megjithatë pasuritë e përfituara në vitin 2012 në vlerë 30,000€ ende nuk ishin regjistruar.	
Inventarizimi i pasurisë kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatës Buxhetore dhe të siguroj se inventarizimi bëhet në baza vjetore.		Inventarizimi vjetor është kryer, mirëpo inventarizimi i pasurive nën vlerën 1,000€ ka qenë i mangët.	
Mungesë e dokumentacionit të pronësisë dhe informacioneve për investimet e bëra nga palët e treta	Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e marra duhet të paraqiten si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor bazë të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunë për vitin përkatës.		Ndonëse janë bërë përpjekje në drejtim të sigurimit të të dhënave nga investitorët, për disa pasuri ende nuk është siguruar dokumentacioni burimor.	
Të arkëtueshmet	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoi një plan të detajuar arkëtimin e borxheve të vjetra.			Nuk janë marrë masa.

Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.		Ende ka borxhe të papaguara nga vitet paraprake për të cilat nuk janë marrë masa për t'u paguar.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i evituar gabimet e paraqitura tek PFV finale. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Ndonëse ka pasur përmirësime gjatë viteve, ende ka mangësi tek shpalosjet e PFV-ve.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të vendos dha zbatoj mekanizma konkret të llogaridhënies ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Pas pranimit të këtij raporti, ne sugjerojmë që të përgatitet një plan i rifreskuar i veprimit për të zbatuar rekomandimet e këtij viti dhe rekomandimet e vitit të kaluar, duke përcaktuar qartë afatet kohore, veprimet dhe personat përgjegjës për realizimin e këtij plani. Një proces monitorimi, po ashtu duhet zbatohet.		Është hartuar plani i veprimit megjithatë nuk ka dëshmi të dhënies prioritet zbatimit të rekomandimeve, me fokus atyre me prioritet te larte. Njëkohësisht nuk ka dëshmi të rishikimit të zbatimit të tyre nga Kryetari.	
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është plotësuar lista e rreziqeve të mundshme që do të ndikonin negativisht në arritjen e objektivave të komunës, dhe të azhurnoj planin strategjik të ndarë për Komunën e Vitisë, duke llogaritur të gjitha kostot përcjellëse për implementimin e saj. Ne sugjerojmë që rishikimi final i pyetësit të vet-vlerësimit të kryhet nga auditimi i brendshëm.	Po		

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari i Komunës duhet sigurojë që plani strategjik është azhurnuar bazuar në nevojat e komunës, dhe të qartësojë përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planit strategjik, duke caktuar persona përgjegjës si dhe të kërkojë hartimin e planit të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.		Përveç raporteve të cilat në baza të rregullta përgatiten për kuvendin komunal, ende mungon përcaktimi i një forme të raportimit formal të drejtorive mbi aktivitetet financiare dhe operative tek Kryetari. Kryetari mban takime me drejtoret, nga ku kemi siguruar procesverbale, megjithëse ato nuk e mbulojnë tërë vitin.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm, dhe të kërkojë nga të gjithë sektorët përkatës që maksimalisht t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.		Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i brendshëm nuk është i kënaqshëm.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.		Mund të themi se ka një realizim të mirë të buxhetit nëpër kategori, megjithëse sfidë mbetet mos realizimi i shpenzimeve që planifikohen nga të hyrat, për të cilat nuk ka një mekanizëm adekuat të inkasimit.	


3.1.1 Të hyrat	Kryetari të sigurojë një plan funksional dhe staf të mjaftueshëm që të përmbushë kërkesat ligjore dhe të verifikoj ndryshimet në gjendjen e pronave në mënyrë që ngarkesat tatimore të zbatohen mbi bazën e të dhënave të rifreskuara.		Janë verifikuar një pjesë e madhe e pronave prej 32%, nevojitet edhe më tutje përkushtim në këtë drejtim.	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet se shërbimi i burimeve njerëzore brenda një afati sa më të shpejtë të siguroj të gjitha konfirmimet e duhura për përvojën e punës, se dosjet e personelit të kompletohen ashtu siç kërkohet me rregullat në fuqi dhe të gjitha pagesat të bëhen në mënyrë të dokumentuar.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, dhe mbajtja e tatimeve në burim të jetë në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.		Mbajtja e tatimit është aplikuar, megjithatë edhe gjatë 2017 janë angazhuar për pozita të rregullta dhe në mungesë të konkurseve.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë që zbatohen kontrole efektive gjatë procesit të planifikimit dhe ekzekutimit të pagesave, se shpenzimet janë klasifikuar në kategoritë e duhura dhe rastet e tilla të mos përsëriten.		Raste të keq klasifikimeve janë përsëritur tek ekzekutimi i pagesave direkt nga Thesari	
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e dhënies së subvencioneve, me konsistencë do të zbatoj të gjitha dispozitat e rregullores.		Raste të tilla nuk janë përsëritur megjithatë ka pasur mangësi në raportimin e subvencioneve.	
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se raportimi i investimeve kapitale në MF do të bëhet çdo tremujor konform kërkesave të LMFP-së, duke u mbështetur mbi evidenca të mjaftueshme mbi progresin e tyre.	Po		

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që do të ndërmerret një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit, dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar se dobësitë e identifikuar do të evitohen në të ardhmen.		Përkundër përmirësimeve, ende ka mangësi të theksuara në fushën e prokurimit.	
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i komunës duhet të zgjidhë problemin e pronësisë së këtyre shkollave dhe të sigurojë dokumentacionin mbështetës nga MASHT për të konfirmuar rregullsinë e regjistrimit të këtyre shkollave.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që çdo pasuri regjistrohet në regjistrat kontabël dhe të sigurojë se të gjitha pasuritë janë përfshirë në procesin e inventarizimit në fund të vitit nga komisionet përkatëse.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i komunës duhet të bëjë aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për pasuritë jo financiare siç parasheh Rregullorja për Menaxhimin e pasurisë jo financiare nr.02/2013 neni 4 paragrafi 1.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet një kontroll dhe vlerësim detal dhe i saktë i LLA. Në mënyrë që raportet të jenë të besueshme dhe të sakta, duhet të shtohet bashkëpunimi me departamentin e tatimit në pronë në kuadër të MF.		LL/ A nga tatimi në pronë janë prezantuar mirë, megjithatë LL/ A nga qiraja janë nënvlerësuar në PFV.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



Komuna e Vitisë



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Sokol Haliti

Kryetar i Komunës

Data: 19.06.2018, Viti,

